



KESHILLI I BASHKISE KORCE

VENDIM

Nr. 69 / dt 3. 11. 2011

Për miratimin e fondit prej 100 000 lekë, për krijimin e partneritetit publiko privat midis Bashkise Korçe dhe Cerdhes private, fituese të procedurave të konkursit

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit dhe bazuar në nenin 111 dhe 113/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 761-771, ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh" dhe neni 8 pika VI/a, ligjit nr 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr 10355 dt. 2.12.2010 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2011", Udhëzimit nr 4 dt. 27.1.2011 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011, si dhe VKB nr. 44 datë 28.7.2011 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2011" si dhe mbas diskutimeve të keshilltareve:

VENDOSI:

1. Të miratojë akordimin e fondit prej 100 000 lekë, , i cili do të përballohet nga fondi i planifikuar për projektin "Prezantim i Korçës në panairë, ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare" me këtë strukturë buxhetore:

PAKESOHET	00	01110	05	Art	602 0000 – 100,000 (Bashkia)
SHTOHET	00	01110	05	Art	604 0000 + 100,000 (Bashkia)

2. Ky fond do të shpallet për konkurs me qëllim krijimin e një partneriteti publiko privat midis Bashkisë Korçe dhe Cerdhes private, fituese të procedurave të konkursit.

3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë për të ndjekur procedurat e konkursit, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances dhe Drejtoria Juridike

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite nga data e shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI

Në mungesë dhe me porosi

ZV/Kryetari

Rajmonda NASE

Rajmonda Nase

